



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.923/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, Osman Hajdari nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Komunën e Prizrenit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.923/2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, Osman Hajdari nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Prizren, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatin për anëtar të Kuvendit Komunal të Prizrenit, Osman Hajdari nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Komunën e Prizrenit, në Vendvotimet: 2062A/01R, 2062A/02D dhe 2042A/08R

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 04.11.2021 nga anëtari për Kuvend Komunal në Komunën e të Prizrenit, Astrit Temaj nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Komunën e Prizrenit, me të cilën pretendon se gjatë procesimit të votave në VV 2069A/01D, pa dashje janë bartur 7 vota nga kandidati me numër 14 tek kandidati i po të njëjtit subjekt politik me numër 15, në VV 2030A/02R iu janë procesuar 0 vota, ndërsa pretendon se ka 3 vota, në VV 2043A/01R, iu janë procesuar 0 vota pretendon se ka 3 vota 2065A/02D.

Andaj përmes apelit ka kërkuar që të bëhet rinumërimi Vendvotimet 2030A, ku si provë ka bashkangjitur 10 deklarata të votuesve si dhe kopje të FRK-ve

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave në lëndës për apelin Anr.907/2021, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezultojnë edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vetë pala ankuese, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatin Astrit Temaj, nga subjekti politik Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Komunën e Prizrenit, në Vendvotimet: 2069A/01D, 2030A/02R, 2043A/02R dhe 2065A/02D, dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale, të vitit 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezultojnë se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenin 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 923/2021 më datën 06.11.2021.

Kryesues i Panelit
Ferki Xhaferi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.